



Monografi

Dekada e parë

Monograph

The first decade



Historia e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë
History of the accounting and auditing profession in Kosovo

Dekada e parë / The first decade

2 0 0 1 – 2 0 1 1

Është një privilegj për mua të prezantoj punën e paraardhësve të mi, të personelit tonë ekzekutiv, të anëtarëve tanë dhe të palëve me interes kombëtare e ndërkombëtare për sa i takon menaxhimit financiar, raportimit dhe auditimit, të cilët, të gjithë së bashku, kanë ndërtuar këtë organizatë profesionale.

Duke shënuar përvjetorin tonë të dhjetë, unë dua të shfrytëzoj këtë mundësi për t'ju falënderuar të gjithë ju, për historinë tonë.

Uroj që publikimi ynë t'ju duket interesant, sepse kjo është historia e krijimit dhe e zhvillimit të një organizate profesionale, e cila është e lidhur ngushtë me krijimin dhe zhvillimin e ekonomisë dhe të shtetit tonë.

Kjo është historia jonë e përbashkët.

— Nazmi Pllana
Kryetar i Këshillit të ShKÇAK



It is my privilege to introduce the work of my predecessors, our executive staff, our membership and the national and global stakeholders in financial management, reporting and auditing who have together built our professional body.

As we mark our 10th Anniversary I take the opportunity to thank all of you for our history.

I hope you find our publication interesting. It is the story of the creation and development of a professional body, that is inextricably linked to the creation and development of our economy and our country.

It is our shared history.

— Nazmi Pllana
President of SCAAK Council

Historia jonë filloi me një ide, e cila u bë një institucion që u shërben nevojave të ekonomisë dhe që ka funksionuar për të orientuar vendin tonë drejt një ekonomie të re e që përmbush rolin e një organizate profesionale moderne të kontabilitetit.

Vështrimi ynë në të kaluarën, është në fakt vështrimi ynë në të ardhmen.

Në fund të dekadës së ardhshme, shpresoj që Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv i asaj kohe të pasqyrojnë suksesin e profesionit tonë bashkë me suksesin e vendit tonë në Bashkimin Evropian.

Të gjithë mund të jemi të sigurt se, nëse ata ruajnë angazhimin tonë për qeverisje të mirë, për t'i shërbyer interesit publik dhe, nëse ruajnë marrëdhëniet miqësore me institucionet partnere që kemi krijuar në tashmë, dekada e dytë e historisë së ShKÇAK-së do të pasqyrojë një sukses më të madh sesa është ky i dekadës së parë.

— Ardiana Bunjaku
Drejtoreshë Ekzekutive ShKÇAK



Our story began with an idea that became an institution that served the needs of the economy and worked to induct our new country to a new economy and the role of the modern professional accounting organization.


As we look back, we look forward.

In another decade, I hope that a future President and Executive Director will reflect the success of our profession and country within the European Union.

We can be confident that if they retain our commitment to good governance, serving the public interest and retaining the lifelong institutional friendships and partnerships we have made, that the second decade of SCAAK's history will reflect greater success than the first.

— Ardiana Bunjaku
Executive Director SCAAK

Rritja e ShKÇAK nëpër vite / Growth of SCAAK through the years



Kosova – fillimi i një vendi të ri	faqe 10
Lindja e ShKÇAK	16
Nga një ide në një institucion	24
Krijimi i kapaciteteve të ShKÇAK	32
Zhvillimi i kapaciteteve të studentëve dhe anëtarëve	42
Promovimi dhe vënia në zbatim e standardeve ndërkombëtare	58
Njohja ndërkombëtare dhe vendore	62
ShKÇAK në 2011 : në shërbim të interesit të publikut	72
Rruga përpara – ShKÇAK 2021	76

<i>Kosovo – beginning of a new country</i>	<i>page 10</i>
<i>The birth of SCAAK</i>	<i>16</i>
<i>From idea to institution</i>	<i>24</i>
<i>Building the capacity of SCAAK</i>	<i>32</i>
<i>Developing the capacity of students and members</i>	<i>42</i>
<i>Promoting and implementing international standards</i>	<i>58</i>
<i>International and domestic recognition</i>	<i>62</i>
<i>SCAAK in 2011 : serving the public interest</i>	<i>72</i>
<i>Looking ahead – SCAAK 2021</i>	<i>76</i>

Kosova – fillimi i një vendi të ri

Më 10 qershor 1999, Kosova bëri hapat e parë drejt një epoke të re dhe të ndryshme ekonomike, politike dhe sociale. Rezoluta 1244 e UNMIK-ut i lejonte Kosovës të themelonte institucionet e veta të përkohshme të vetëqeverisjes, nën mbikëqyrjen dhe me mbështetje të ofruar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Pas shpërbërjes së Republikës së ish -Jugosllavisë dhe pas një periudhe paqartësie politike e ekonomike, e cila arriti kulmin me një konflikt të armatosur, Qeveria e parë e Kosovës përballë me sfida të mëdha, si për sa i takon rindërtimit të vendit pas konfliktit, ashtu edhe për sa i takon krijimit të një shteti të ri.



Kosovo – the beginning of a new country

On 10 June 1999 Kosovo took its first tentative steps into its new and different economic, political and social era. UNMIK Resolution 1244 permitted Kosovo to establish its own provisional institutions of self-government with oversight and support provided by the United Nations Mission in Kosovo (UNMIK). Following the dissolution of the former Yugoslavia and a period of political and economic uncertainty, culminating in a conflict, the first Government in Kosovo faced the challenges of both post-conflict reconstruction as well as construction of a new state.

Sistemi i mëparshëm ekonomik, që zbatohet në ish-Jugosllavinë, përfaqësonte një model të ndryshëm socialist nga ai që ishte në vendet e tjera të Evropës Lindore, Qendrore dhe Jugore, vendeve që nuk bënë pjesë në atë që sot njihet si “Perëndim”. Sistemi jugosllav bazohej në konceptet e “pronësisë sociale”, në dallim nga “pronësia e shtetit”, gjë që nënkuptonte një model të ndryshëm të qeverisjes dhe funksionimit të shumicës së aktiviteteve ekonomike. Raportimi financiar dhe auditimi, ashtu siç nënkuptohen dhe ushtrohen në vendet e ekonomisë së tregut, nuk ekzistonte fare, ndërkohë që vëmendja më e madhe u kushtohej mbajtjes së llogarive, raportimit për qëllime statistikore, verifikimit të shpenzimeve dhe të ardhurave, kontrollit të imponuar nga shteti, i cili synonte ta bënte të sigurt se veprimeve në përputhje me hollësitë e rregulloreve për arkëtimin, pagesën dhe regjistrimin në libra të të hyrave dhe kostove të sipërmarrjeve.



17 shkurt 2008-Shpallja e pavarësisë së Kosovës.

17 February 2008 – Independence Day of Kosovo.

The former economic system created within Yugoslavia represented a different socialist model to that practiced by other East, Central and Southern European countries that were not a part of what is known as the “west”. The Yugoslav system was based on notions of “social ownership” as opposed to “state ownership”, implying a different model for the governance and operation of most economic activities. Financial reporting and auditing, as understood and practiced in market economies did not exist, rather the emphasis was on book-keeping, statistical reporting, income and expenditure verification and state sponsored control, aimed at ensuring compliance with the detailed regulations on the receipt, disbursement and book-keeping of enterprise revenues and costs.

Gjatë periudhës nga viti 1999 deri në vitin 2008, Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ) të Kosovës adaptuan politika të krijuara për të mbështetur krijimin e një ekonomie të tregut. Megjithëse pasiguria politike për të ardhmen e Kosovës UNMIK 1244, krijonte pengesa serioze, IPVQ-të u bënë pjesë e një sërë iniciativash evropiane dhe ndërkombëtare, që synonin të zgjidhnin mosmarrëveshjet politike dhe që lehtësonin lindjen e një Kosove të re dhe të pavarur.

Më 17 Shkurt 2008, Qeveria e Kosovës deklaroi pavarësinë dhe themeloi menjëherë një kushtetutë të re, që bazohej në rekomandimet e gjera të raportit të Ahtisaarit. Kështu lindi Republika e Kosovës, dhe flamuri i ri i Kosovës përfaqësoi perspektivën e saj evropiane, bashkë me faktin se ajo është atdheu i të gjitha etnive që jetojnë në të.



During the period 1999 through 2008 the Provisional Institutions of Self Government (PISG) of Kosovo adopted policies designed to support the creation of a market economy. Hampered by political uncertainty regarding the future of Kosovo UNMIK 1244, the PISG participated in several European and International initiatives designed to resolve political disagreements and facilitate the birth of a new and Independent Kosovo.

On February 17th 2008 the Government of Kosovo declared independence, and quickly institutionalized the new constitution, based on the wide ranging recommendations of the Atishari report. The Republic of Kosovo was born, and the new flag adopted by Kosovo represented both its European perspective, as well as its ownership by all constituent ethnic peoples.

Pavarësia fillimisht solli njohjen e Kosovës nga shumë vende të botës, bashkë me anëtarësinë e saj në Bankën Botërore. Kriza financiare e vitit 2008 shënoi një ngadalësim të theksuar të rritjes ekonomike në Evropë dhe në shkallë globale dhe kjo solli sfida më të mëdha për Kosovën e re. Në fund të kësaj dekade të parë, Qeveria e Kosovës nisi një program për implementimin dhe vënien në zbatim të kërkesave për anëtarësinë në Bashkimin Evropian dhe për zhvillimin e potencialit ekonomik të vendit.



Independence initially brought recognition of Kosovo by many countries and membership of the World Bank. The financial crisis of 2008 led to a marked slowdown in economic growth in Europe and globally, with resulting greater challenges for the new Kosovo. By the end of the first decade the Government of Kosovo had embarked upon a program of implementing the requirements for European Union membership, and developing the economic potential of the country.



“

Këtë elan që ju keni në ekipin tuaj, me mekanizma të shtetit dhe ndërkombëtar tregon se e keni dhe e kemi seriozisht. Pavarësisht që ju gëzoni statusin e pavarur unë them se jeni jetësisht të orientuar që të bëheni pjesë kreative e punës për ecjet dhe zhvillimet tona si shtet.

The willingness that you have in your team, with the state and international mechanisms, shows that we are serious. Despite that you enjoy independent status, I say that you are vitally oriented to become part of the creative work for development of our state.”

Fatmir Sejdiu

Ish Presidenti i Republikës së Kosovës / Ex president of Republic of Kosovo





“

Jam ndier shumë krenar kur Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës e arriti anëtarësimin në Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve. Kjo tregon dedikimin e fortë të këtij institucioni dhe të njerëzve që kanë punuar dhe udhëhequr me të.

I was particularly proud when the Society of the Certified Accountants and Auditors of Kosovo was awarded its full membership to the International Federation of Accountants. It shows how much dedicated, this institution and all the people who work and manage it are.”

Ahmet Shala

Ish Ministër për ekonomi dhe financa / Ex minister of Economy and Finance



Lindja e ShKÇAK – 16 Maj 2001

Menjëherë pas daljes nga konflikti i armatosur në vitin 1999, rindërtimi i Kosovës ndihmohej nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe shumë prej agjencive të saj humanitare e të zhvillimit, - nga Banka Botërore, Bashkimi Evropian, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim, bashkë me donatorë, agjenci, organizata dhe nga fondacione të tjera bamirëse bilaterale. Me kthimin e qytetarëve të Kosovës në shtëpitë e tyre, filloi të vihej rregull dhe kështu nisi historia e ndërtimit të vendit.



Ceremonia e parë e ndarjes së diplomave, dhjetor 2002.

First certification ceremony, December 2002.

The birth of SCAAK – 16 May 2001

In the immediate wake of the end of the war in 1999 Kosovo was assisted in post war reconstruction by the United Nations and its many humanitarian and assistance agencies, the World Bank, the European Union, the United States Agency for Development, as well as many other bilateral donors, agencies and global charitable organizations and foundations. As large numbers of Kosovo citizens returned to their homes and order was restored, the work on building a country started.

Punëdhënësit më të mëdhenj në Kosovë ishin agjencitë ndërkombëtare dhe institucionet qeveritare, kështu që, pothuaj që në fillim, shtrohej kërkesa e jashtëzakonshme për punonjës me aftësi në punë të kontabilitetit dhe në menaxhimin financiar.

Numri i personave që punonin në këto funksione ishte shumë i vogël dhe disa prej tyre kishin certifikata të lëshuara nga agjencitë dhe organizmat jugosllave të sistemit të mëparshëm ekonomik. Si rrjedhojë e trajnimeve profesionale që ofroheshin nga organizatat ndërkombëtare, komuniteti i kontabilitetit në Kosovë tashmë u ndërgjegjësua se sistemi i vjetër i trajnimeve dhe i certifikimit i takonte një sistemi të vjetër ekonomik që kishte reshtur së ekzistuari. Duke pasur kontakte me kontabilistë dhe auditorë të kualifikuar nga Evropa dhe vende të tjera, kosovarët e kuptuan tërësisht se ky ishte një profesion relevant për nevojat e ekonomisë së tregut, po ky profesion, ose duhej të krijohet nga e para ose duhej të importohet nga Jashtë.



Gjenerata e parë e Teknikëve të Kontabilitetit, dhjetor 2002.

First generation of Accounting technicians, December 2002.

The largest employers in Kosovo were the international agencies, and the Governmental institutions, and almost from the beginning there was a demand for employees with financial management and accounting skills.

The community of persons working in these roles was quite small, and some held certificates issued by the Yugoslav agencies and bodies under the former economic system. As a result of occupational training courses provided by the international organizations, the Kosovo accounting community recognized that the old training and certification system belonged to an old economic system that no longer existed. Coming into contact with qualified accountants and auditors from Europe and further afield, the Kosovars realised that there was a profession that was relevant to the needs of the market economy, but this needed to be either created or imported.

Znj. Thuy Mellor erdhi në Kosovë nga Australia për të ndihmuar krijimin e kornizës financiare të Kosovës, dhe ishte një person i rëndësishëm për sa u takon këshillimeve gjatë përpilimit të Ligjit Kosovar për Raportimin Financiar të Organizatave të Biznesit, i cili hyri në fuqi nga UNMIK-u në vitin 2001. Kjo rregullore, e cila është në fuqi ende, tash e një dekadë, krijoi Bordin Kosovar për Standardet e Raportimit Financiar dhe shërbeu si shtysë për krijimin e ShKÇAK-së.

Celësi i suksesit të ShKÇAK ka qenë vizioni i njerëzve, të cilët kishin eksperiencë ndërkombëtare, eksperiencë vendore dhe energjinë e anëtarëve të rinj, të cilët u bashkuan në këtë organizatë profesionale që i shërbente qëllimit të anëtarëve të saj për të zhvilluar më tej profesionin.



Ms. Thuy Mellor came to Kosovo from Australia to assist in building the financial framework of Kosovo, and was instrumental in advising on the Kosovo Law on Financial Reporting for Business Organisations, that was promulgated by UNMIK in 2001. This regulation, still in place a decade later, established the Kosovo Board for Standards in Financial Reporting, and led to the impetus to form SCAAK.

Anëtarët që themeluan ShKÇAK-në, këtë shoqatë e regjistruan në 16 maj 2001. Synimi i themeluesve ishte krijimi i një profesioni të ri, i cili t'i shërbente qëllimit në ekonominë e re të tregut.

Anëtarët që themeluan ShKÇAK janë:


Jan Tyl, Lekë Musa, Shukri Gashi, Bujar Sokoli, Mustafë Ibrahim, Lindita Shala, Gina Kuta, Bashkim Uka, Tomorr Zhaveli, Faton Zeqiri, Avni Jashari, Gëzim Pirana, Eugen Nuri.

The key to success of SCAAK was the vision of the people that contained a combination of international experience, local experience and the energy of young members, who gathered to establish a professional association which will serve the interest of its members in developing the profession.

The Founding Members of SCAAK therefore registered the Society on 16 May 2001. The intent of the founders was the creation of a new profession that is fit for purpose in the new market based economy.

The founding members of SCAAK are:

Jan Tyl, Lekë Musa, Shukri Gashi, Bujar Sokoli, Mustafë Ibrahim, Lindita Shala, Gina Kuta, Bashkim Uka, Tomorr Zhaveli, Faton Zeqiri, Avni Jashari, Gëzim Pirana, Eugen Nuri.





“ Kjo është një arritje e rëndësishme, pasi që SHKÇAK është njëra ndër pak shoqata profesionale të kontabilitetit dhe auditimit në Ballkan që kanë përmbushur standardet rigoroze që ka arritur njohjen nga IFAC. USAID është krenare që ka mbështetur SHKÇAK që nga themelimi i saj. Fakti që SHKÇAK ka përmbushur kriteret e rrepta të anëtarësimit në IFAC tregon qëndrueshmërinë financiare dhe operationale të SHKÇAK si një organizatë.

This is a significant accomplishment, as SCAAK is one of the few professional accounting associations in the Balkans to have met the rigorous standards and achieve recognition by the IFAC. USAID is proud to have supported SCAAK since its establishment. The fact that SCAAK has met the strict IFAC membership criteria indicates SCAAK's financial and operational viability as an organization.”

Patricia Rader

Ish udhëheqëse e misionit të USAID/Kosovë / Ex mission Director of USAID/Kosovo





“Gjërat që janë arritur, e bëjnë ShKÇAK një nga shoqatat shumë të pakta profesionale në rajon të cilat kanë përmbushur synime kaq të rëndësishme, për sa i takon ofrimit të shërbimeve cilësore dhe integritetit ndërkombëtar. Siç edhe mund të shihet, ka përsëri shumë e shumë sfida me të cilat do të duhet të përballohemi, por kam besim të plotë se ShKÇAK do të ofrojë kontributin e saj tepër të çmuar (ashtu siç ka bërë gjithmonë) për sa i takon ecjes përpara për të vënë në zbatim një kornizë moderne të raportimit financiar, për të arritur kështu integritimin gradual e të plotë në Bashkimin Evropian.

All the achievements make SCAAK one of the very few professional associations in the region to have reached such important goals in providing quality services and international integration. As we can see, a lot of challenges still stand in front of us but I am fully confident that SCAAK will provide an invaluable contribution (as it has so far) in moving ahead with the implementation of a modern financial reporting framework towards their gradual and full integration with the EU.”

Ranjit Nayak

Përfaqësues i Bankës Botërore në Kosovë / World Bank Representative in Kosovo



“Të kesh vazhdimësi, dmth. të sigurosh përjetësi – Shoqata këtë e bëri.
Sustainability means to keep living forever and the Society did it.”

Bekim Berisha

Anëtar i Komisionit për Standarde Profesionale /
Member of Professional Standards Committee



“ Që nga fillimi i punës së vet, SHKÇAK ka ofruar një bashkëpunim të sinqertë dhe profesional me ATK. Besoj se ecja e përbashkët është më e lehtë. Uroj që të ketë vetëm suksese dhe zhvillim për SHKÇAK në fushën e profesionit të kontabilitetit.

Form its beginnings, SCAAK has offered an honest and professional cooperation with KTA. I believe that walking hand in hand has made it easier for both of us. I simply wish to SCAAK a lot of success and new developments in the field of professional accounting.”

Sakip Imeri

Anëtar i Komisionit për tatime / *Member of the Taxation Committee*



“ Përkundër të gjitha sfidave të kohës ne e bindëm edhe skeptikun e fundit në këtë botë se jemi dhe mbetemi shoqatë profesionale me vlera të larta dhe mision për të shërbyer interesit publik. Me punë dhe vullnet në Kosovaret mundemi shumë më tepër.

Despite all the challenges, we convinced even the last skeptic in this world that we are and will remain a very professional society with high values and a mission to serve the public interest. With hard work and willpower, we, Kosovars are able to achieve much more.”

Adrian Alo

Anëtar i Komisionit për standarde profesionale /
Member of the Professional Standards Committee



Rezultatet e punës profesionale të Shoqatës pa marrë parasysh disa të meta janë tepër optimiste, andaj që aktivitetet e saj të mos jenë të mbyllura në një kuti duhet të shkruhet një Libër.

The results achieved through the professional work of the Society, regardless of several shortcomings, are such that bring forth optimism, and that is why its activities should not be kept silent and locked into a box. A whole book should be written on them."

Ymer Mehmeti

Anëtar i Komisionit disiplinor / *Member of the Disciplinary Committee*



ShKÇAK që nga themelimi e deri më sot, të gjithë atyre që u përcaktuan për profesionin e Kontabilistit dhe Auditorit, iu ofroi mundësinë që të ngriten profesionalisht, të certifikohen dhe të jenë të nivelit të njëjtë me të gjithë kolegët në rajon dhe më gjerë.

From its incorporation to this day, SCAAK has offered to all those who opted for professional accountants and auditors, the opportunity to rise professionally, and be certified by the same levels with their colleagues in the region and beyond."

Besa Sahitaj Berisha

Anëtare e Komisionit për nominime / *Member of the Nomination Committee*



Jam i impresionuar me udhëheqjen e shoqatës nga Ardiana Bunjaku dhe çdo herë mendoj arritjet e shoqatës dhe sukseset e saj.

I am very impressed with the leadership of Ardiana Bunjaku, all the time I think of Society's achievements and success."

Liman Morina

Anëtar i Komisionit Disiplinor /

Member of the Disciplinary Committee

Nga një ide në një institucion

Që në fillim, themeluesit e ShKÇAK-së ishin në dijeni për faktin se që të zhvillohej një organizatë profesionale për kontabilistë dhe auditorë, ishte i nevojshëm krijimi i një kornize të fortë institucionale dhe, meqenëse Kosovës i nevojiteshin aftësi dhe kompetenca të reja, ndihma nga donatorët ndërkombëtarë do të ishte diçka thelbësore. Gjatë pjesëmarrjes në një konferencë për Partneritetin e Evropës Juglindore mbi Zhvillimet në Kontabilitet (SEEPAD), në vitin 2001, Banka Botërore dakordoi programin e parë të asistencës teknike për Kosovën, duke themeluar Shoqatën dhe zyrat e saj ekzekutive nën udhëheqjen e Z. Keith Cornish. Një rol të madh në këtë periudhë fillestare luajtën Znj. Silvia Minotti dhe Znj. Silvia Mauri, të cilat kontribuan jo vetëm si personel i Bankës Botërore, por edhe ishin zëri i shoqatës në institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare.



Ceremonia e parë e ndarjes së diplomave, dhjetor 2002.

First certification ceremony, December 2002.

From idea to institution

From the beginning of SCAAK the founders recognized that an institutional framework was required to develop the professional body for accountants and auditors, and because new skills and competences were needed for Kosovo, support from the international donors would be vital. Whilst attending a conference of the South Eastern European Partnership on Accountancy Development (SEEPAD), in 2001, the World Bank agreed the first technical assistance program for Kosovo on establishing the Society and executive office headed by Keith Cornish. In this period Ms. Silvia Mauri, and Ms. Silvia Minotti played a significant role, by contributing not only as a the World Bank's staff, but also they were the voice of SCAAK in relevant local and international institutions.

Në vitin 2002, Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID) iu bashkua historisë, duke ofruar asistencë shtesë për të ndihmuar ShKÇAK-në që të krijonte plan-programin e saj fillestar, i cili synonte të edukonte kontabilistët dhe studentët për standarde ndërkombëtare të kontabilitetit (SNK/IAS). Znj. Dardane Peja, mbikëqyrëse e projekteve në USAID, përmes projektit për mbështetjen e bizneseve në Kosovë (KBS), me Z. Jan Tyl në krye, udhëhoqen skuadrën e parë të asistencës teknike dhe ndihmuan ShKÇAK-në për të zhvilluar trajnimet e saj të para. Në këtë mënyrë në Kosovë u krijua koncepti i Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (EVP), me një skuadër të madhe ekspertësh të huaj, që ofronin trajnime të gjata, të cilat ishin përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe, për një komunitet përherë e më të madh të profesionit të kontabilitetit dhe të auditimit, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik të Kosovës.



Ekipi i zyrës ekzekutive me këshilltarët nga projektet e Bankës Botërore dhe USAID.

Executive Office team with consultants from World Bank and USAID Projects.

By 2002, the United States Agency for International Development (USAID) came on board, to provide additional assistance to help SCAAK build its initial syllabus, aimed at educating accountants and students on international accounting standards (IAS). Ms. Dardane Peja, supervisor of USAID projects, through the Kosovo Business Support project, led by Mr. Jan Tyl, headed the first technical assistance team, helped SCAAK to develop its first courses and participated in the delivery of the courses. Thus, the concept of CPD was established in Kosovo, with a largely foreign team of experts providing lengthy training courses, translated into the Albanian and serbian language, to the growing community of accounting and audit staff in both private and public sectors of Kosovo.

Shoqata përballej me një lloj rezistencë kundërshtuese, për shkak se kontabilistët e përgatitur në sistemin e mëparshëm, vazhdonin të adaptonin rregullat kontabël të sistemit të mëparshëm dhe nuk mirëpritën programin e edukimit, që u krijua dhe ofrohej nga ShKÇAK, tërë kjo për shkak se diçka e tillë shtronte kërkesën që edhe ata duhej të ndiqnin trajnimet e gjata që ofroheshin nga ekspertë ndërkombëtarë.

Pengesat që u shfaqën në trajnimet e para, ishin orientimi i kontabilistëve ndaj standardeve të bazuara mbi parime dhe koncepte të raportimit modern financiar, bashkë me qartësimin e rolit të auditorit. Ofrimi i trajnimeve zyrtare dhe provimet e pavarura, të njësuara me standardet ndërkombëtare, kundërshtoheshin në formë ankesash dhe reagimesh negative nga ata që mendonin se çertifikatat që kishin marrë në sistemet e mëparshme ekonomike, përfaqësonin një licencë për të ushtruar gjithë jetën këtë profesion.

“

Fillimisht, për ShKÇAK, ka pasur dy momente kyçe në ecjen e tij përpara. I pari ishte vendimi për të mos adoptuar asnjë gjë nga e kaluara, për të filluar një profesion të ri, të bazuar mbi standardet ndërkombëtare dhe momenti i dytë ishte krijimi i një zyre më të fortë ekzekutive e cila do të shtynte përpara procesin e zhvillimit.”

Bashkim Uka

Kryetari i Këshillit të ShKÇAK (2002-2005)



The society faced resistance as the accountants educated in the previous system inclined to continue with the adopted accountancy rules of the former system, and did not welcome the transitional education program that was put in place by SCAAK in order to re-tool them, as it meant attending lengthy courses delivered by international experts and translated in local languages.

The initial challenges at the first trainings were to orient the accountants to principles based standards and the concepts of modern financial reporting and the role of the auditor. The provision of formal training and independent examinations, benchmarked to international standards, was resisted in the form of complaints and negative reactions from some who felt that their previous certificates earned during the time of former economic system represented a license for lifetime practice.

Në fund të vitit 2002 Shoqata mori në punë Ardiana Bunjakun, për të krijuar Zyrën Ekzekutive për ShKÇAK-në dhe kështu lindi një institucion i cili do të bënte të mundur zhvillimin dhe rritjen e sigurt të Shoqatës. Që në fillim, ShKÇAK krijoi një sistem të qeverisjes së mirë, sipas të cilit, Kryetari i saj do ushtronte një post vullnetar, i cili nuk paguhej dhe duhej të zgjidhej nga Këshilli, i cili, dhe ai vetë, duhej të zgjidhej nga anëtarët e ShKÇAK-së në Asamblenë e saj të Përgjithshme. Roli i Këshillit ishte krijimi dhe ofrimi i mbikëqyrjes gjatë implementimit të strategjisë, kurse roli i Zyrës Ekzekutive do të ishte vënia në zbatim e strategjisë dhe ofrimi i shërbimeve ndaj anëtarëve dhe studentëve.

“


For SCAAK there were originally two key moments of its forth-moving direction. First, was the decision not to adopt anything from the past, to start with a profession based on international standards, and the second moment was the creation of a more powerful executive office that will propel the development process forward.”

Bashkim Uka

President of SCAAK Council (2002-2005)



By the end of 2002 the Society hired Ardiana Bunjaku to set up the Executive office for SCAAK, thus providing for an institution that would ensure the orderly development and growth of the Society. From the beginning SCAAK put in place a governance system under which the President would be an unpaid volunteer position, elected by a volunteer Council that would be elected by the members of SCAAK at the Assembly. The role of the Council was to set and provide oversight on the implementation of strategy, and the role of the Executive office would be to carry out the strategy and develop the services to meet the needs of members and students.



“ Ka shumë e shumë kujtime nga koha që kam kaluar në Kosovë dhe të përpjekjeve të përditshme të personelit të ShKÇAK, nën udhëheqjen e Ardianës... ajo që më pëlqen më tepër të sjell ndërmend, dhe që më bëri të besoj se me të vërtetë këta njerëz do t'ia dilnin mbanë, është serioziteti me të cilin u trajtua organizimi i provimeve, duke filluar nga përgatitja e materialeve dhe pyetësorëve, deri tek ruajtja dhe logjistika përkatëse për të garantuar kështu sjelljen në jetë në mënyrën e duhur e të përshtatshme të vlerave që përfaqësojnë certifikatat e lëshuara nga ShKÇAK.

There are so many memories of the time spent in Kosovo and the daily efforts made by all SCAAK staff under the leadership of Ardiana... The one I like to remember, that made me believe that you could do it, is the seriousness that ruled the important task of giving exams, from the preparation of the materials and questionnaires, their storage, the logistic so to allow for the smooth and correct implementation of what has been always one of the guarantee of the certificates issued by SCAAK.”

Silvia Mauri

Banka Botërore / World Bank



“ Shoqata me suksesin e arritur, tashmë ka tejkaluar disa herë parashikimet fillestare. Pjesa më me rëndësi është që asgjë nuk ishte e rastësishme.

The success that the Society has already achieved has exceeded by far all initial forecasts. What matters most is that nothing was accidental.”

Afërdita Pustina

Ish asistente ekzekutive / ex Executive Assistant



“ Ajo ditë... ende e kujtoj atë ditë... takimin tonë të parë me ShKÇAK... ShKÇAK ishte një nga institucionet që mbështetej nga ky projekt financiar nga Banka. Në atë kohë, ShKÇAK dhe ne i kishim zyrat në të njëjtën ndërtesë. Takimi ynë ishte më shumë se i mjaftueshëm që ne, skuadra e re e Bankës, të kuptonte se ShKÇAK do të ishte një institucion fitues, një organizatë e shëndoshë dhe me reputacion të shkëlqyeshëm, e cila do të ishte e aftë të funksiononte në një mjedis të vështirë e që do të kapërcente pozitivisht të gjitha vështirësitë ose problemet.

That day... I still remember that day... our first meeting with SCAAK... SCAAK was one of the institutions supported by that Bank-funded project. At that time, SCAAK's office was in the same building as our office. That first meeting was more than enough for the Bank's new team to fully realize that SCAAK was going to become a winning institution, a sound and highly regarded organization able to successfully operate in a difficult environment and to positively overcome any difficulty or problem.”

Silvia Minotti
Banka Botërore / World Bank





“ Anëtarësimi në Shoqatë më është dukur një hap i vogël në vitin 2005, hap i cili doli të jetë një hap i qëlluar për të nisur një karrierë profesionale. Sot, ndihem i lumtur që gjendem në një pozicion nga i cili, nëpërmjet Shoqatës, mund të kontribuoj në implementimin e standardeve më të larta në lëmin e kontabilitetit dhe auditimit në Republikën e Kosovës.

Back in 2005, becoming a member of the Society seemed like a small, irrelevant action, but it turned out to be a firing step to launch a terrific professional career. Today, I feel happy to find myself in a position from which, through the Society, I can contribute to the implementation of higher standards in the field of accounting and auditing in the Republic of Kosovo.”

Visar Peci

Anëtar i Komisioni për edukim profesional / Member of the Professional Education Committee



“ Duke punuar me SHKÇAK, jo vetëm që kam pasur mundësinë të ofroj aftësitë dhe eksperiencën time, por ajo që është më e rëndësishme, ka pasur mundësinë të mësoj nga SHKÇAK se suksesi është gjithmonë i arritshëm nga një skuadër e angazhuar, një menaxhment i fokusuar dhe ambicioz dhe me mbështetjen e një tërësie të anëtarëve të dedikuar. I uroj SHKÇAK shumë e shumë vite të tjera të suksesshme.

Working with SCAAK, I was not only able to give of my skills and experience, but more importantly I learnt from SCAAK the success attainable by a committed team, a focused and ambitious management and the support of a dedicated membership. Wishing SCAAK many more successful years.”

Amina Rasool

Ish këshilltare me projektin e BE / ex Consultant with the EU Project

“ Të bësh të ditura aspiratat e tua ndaj tjerëve (dhe sidomos të kërkosh që ata të bëhen pjesë e tyre) kërkon më shumë se sa thjeshtë kurajo. Siç thotë dhe shprehja e vjetër: “Ata që nuk dëgjonin dot muzikën, mendonin se ata që vallëzonin ishin çmendur”. Dhe kjo është pikërisht ajo që unë i uroj ShKÇAK-ut të vazhdojë të bëjë në të ardhmen: Ndiqni ritmin dhe rrugën tuaj. Të gjithë do të admirojnë kurajon dhe sukseset e arritura!

It takes a lot of courage to put your aspirations out there for everybody to see (or be a part of them). As an old adage says: “Those who danced were thought to be insane by those who couldn’t hear the music”. And this is exactly what I hope SCAAK will never stop doing in its future endeavors: keep following its own rhythm and travel its own road. Everyone will applaud the courage and await the success!”

Alma Xhemalaj

Ish udhëheqëse e Departamentit Profesional / *Ex Team Leader of Professional Department*



“ Është kënaqësi e madhe të punosh për një organizëm të njohur ndërkombëtarisht, meqë kjo domosdoshmërisht ndikon që të prodhosh asgjë tjetër pos punë të standardeve më të larta etike dhe profesionale. Nëse ndjek shembullin e ShKÇAK, do të kuptosh që pavarësisht sa i vogël mund të jesh, mund të arrish rezultate të mëdha po e pate vullnetin dhe po e mbështete këtë vullnet edhe me punë të zellshme.

It is a great pleasure to work for an internationally recognized body, since this necessarily induces one to produce nothing else than work of the highest ethical and professional standards. If one follows SCAAK, they come to understand that no matter how small they may be, great results could have been achieved, have they had a great willpower and had they supported such willpower with really hard work.”

Arian Zeka

Ish asistent ekzekutiv / *ex Executive Assistant*



Krijimi i kapaciteteve të ShKÇAK

Anëtarët themelues të ShKÇAK-së u angazhuan në një program për informimin e të gjitha palëve me interes në sistemin e raportimit financiar për sa i takon natyrës së punës së kontabilistëve dhe të auditorëve, natyrës dhe karakteristikave të standardeve e institucioneve globale dhe evropiane si dhe për sa i takon rolit të mundshëm të një shoqate të re, e cila t'u shërbente nevojave të ekonomisë së Kosovës.

Në këtë mënyrë, në fazat fillestare, lindja e profesionit parakuptonte pengesa serioze për sa i takon përpunimit teknik të profesionistëve të kontabilitetit e auditimit dhe krijimit të standardeve të reja për hyrjen në profesion, të bazuara mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira. Ajo që një periudhë sfiduese, në të cilën rritja fillestare e ShKÇAK-së hasi në një rezistencë të madhe, dhe për këtë arsye ishte e ngadaltë.



Synimi ynë është të ndryshojmë mënyrën se si përceptohet një kontabilist, bashkë me rolin që kontabilistët luajnë në biznes, pra në vend të një mbajtësi të thjeshtë të llogarive ose të një personi që thjeshtë është ekspert në paraqitjen e sa më pak tatimeve duam të shihet një person i cili e ndihmon biznesin të rrisë fitimet duke sjellë në të praktika moderne të profesionit të kontabilitetit.”

Lekë Musa, Kryetar i Këshillit të ShKÇAK (2001-2002)



Building the capacity of SCAAK

The founding members of SCAAK committed to a program of informing all stakeholders in the financial reporting system to the nature of the work of accountants and auditors, the nature and features of global and European standards and institutions and the potential role of a new Association, provided it served the needs of the economy of Kosovo.

Thus, in the initial stages, the birth of the new profession meant a significant challenge in re-tooling the accounting and audit professionals, and setting new standards for entry to the profession, based on international standards and best practices. This was a challenging period, in which the initial growth of SCAAK was resisted, and quite slow.

Në vitin 2002 filloi edhe programi i ShKÇAK-së për çertifikimin e auditorëve ligjorë, pas miratimit të tij nga Bordi Kosovar për Standardet e Raportimit Financiar (BKSRF/KBSFR). Në mars 2002 filluan trajnimet në gjuhën shqipe. Me synimin për të adaptuar ekspertizën e duhur, ky ekip përfshinte ekspertë ndërkombëtarë dhe trajnerë vendorë të mundshëm. Në vitin që pasoi, trajnimi filloi edhe në gjuhën serbe.

Megjithëse programi i ri i trajnimeve ishte i ndryshëm nga ai i vjetri, procesi i adaptimit nuk ishte edhe aq i thjeshtë. Fillimisht, niveli i kalueshmërisë në provime ishte i ulët. Megjithatë, angazhimi për të vazhduar përpara, ishte i shkëlqyeshëm.

Edhe mungesa e përdorimit të teknologjive informative rezultonte në mungesën e informacioneve të përshtatshme për komunitetin e kontabilitetit. ShKÇAK ndjeu nevojën për të njohur publikun me sa më shumë informacione, në mënyrë që të promovoheshin vlerat e profesionit.



Our aim is to change the perception of an accountant and the role that accountants play in a business from that of being a pure bookkeeper and someone who has expertise in underreporting tax to someone that helps business in increasing the profits by bringing modern professional accountancy expertise."

Lekë Musa, President of SCAAK Council (2001-2002)



In 2002, the SCAAK program on certification for statutory auditors was presented to and approved by the Kosovar Board for Standards in Financial Reporting (KBSFR). On March 2002 the trainings began in the Albanian language. With the intention to adopt the expertise, the team included international experts and potential local trainers. The training was extended to Serbian during subsequent years.

Even though the new training program differed from the former system, the adaptation process was not effortless. Initially, the level of success in exams was relatively low. Nevertheless, there was a noticeable commitment to continue further.

The lack of use of informative technology also resulted in the lack of adequate information for the accountant's community. SCAAK felt the need to inform the public with as much information possible in order to promote the values of the profession.

Një arritje tjetër në zhvillimin e ShKÇAK-së ishte fillimi i botimit periodik të revistës “Kontabiliteti Bashkëkohor”, e cila i dedikohet komunitetit të kontabilistëve. Kjo revistë publikonte opinionet, raportet, analizat tatimore, standardet dhe çështje të tjera që ishin në interes të profesionit të kontabilitetit në Kosovë dhe jashtë saj.

Me anë të zhvillimeve teknologjike, ShKÇAK zhvilloi shërbimet e saj me anë të ueb-faqes zyrtare, me synimin për të ofruar një kanal të përmirësuar komunikimi me anëtarët e saj. Kjo ueb-faqe u bë një metodë komunikimi me studentë dhe anëtarë, për sa u takon trajnimeve, provimeve e rezultateve të tyre dhe ngjarjeve në Edukimin e Vazhdueshëm Profesional.

Gjenerata e kontabilistëve të porsaçertifikuar u mirëprit nga publiku dhe punëdhënësit e sektorit privat, kurse përfitimet e strategjisë fillestare të ShKÇAK-së filluan të jepnin frytet e para.



Another hallmark in the development of SCAAK was the production of the publication of the periodical “Kontabiliteti bashkekohor”, which was dedicated to the community of accountants. This periodical published opinions, reports, tax analysis, standards and other issues with interest for the profession of accounting in Kosovo and abroad. .

Through the development of technology, SCAAK has expanded its services through its website, with the intention to provide an improved channel of communication with its members. The website became a means of communication with students and members regarding trainings, exams and results and CPD events.

The generation of newly certified accountants was welcomed by the community of public and private sector employers, and the benefits of the initial strategy of SCAAK began to pay off.

Vlerat e ShKÇAK-së filluan të lulëzonin dhe numri i anëtarëve të rinj u rrit në një shkallë të madhe, kurse punëdhënësit ShKÇAK-në filluan ta shihnin si një shoqatë të kontabilistëve me njohuri të gjera në kontabilitet, tatime dhe auditim.

Zhvillimi i ShKÇAK-së si një organizatë transparente, e ka bërë atë një pjesë integrale të ekonomisë së tregut, si diçka të pavarur nga konjunkturat politike dhe të ndërtuar në përputhje me normat ndërkombëtare.

Në kohë të pasigurive ekonomike, në kuptimin global, rajonal dhe kombëtar të fjalës, nevoja për profesionistë të aftë, kompetentë dhe të dedikuar të kontabilitetit, të auditimit, të qeverisjes së korporatave dhe të fushave të tjera, është cilësuar gjithmonë nga ShKÇAK si diçka thelbësore.



SCAAK's values began to flourish and its numbers of young members increased noticeably, while taking into consideration that the employers began to see SCAAK as a foundation of Accountants with ample knowledge in accounting, taxes and auditing.

The development of SCAAK as a transparent body has made it to be an integral part of the market economy, established independent from political inclinations and build on sound legal basis in line with international norms.

At times of economic insecurity, in a global, regional, and national sense, the need for candid, competent, and dedicated professionals in accounting, auditing, corporate governance and other relevant fields was regarded by SCAAK as crucial.


ShKÇAK inkurajon të gjithë punëdhënësit që në të ardhmen të shohin dhe të frymëzohen nga ndryshimet e jashtëzakonshme në fushën e edukimit dhe trajnimit profesional.

ShKÇAK dhe partnerët e saj në zhvillim, kanë rënë dakord për një vizion dhe synime të qarta në të ardhmen. Personeli profesional që angazhohet në këtë proces, ka krijuar një strategji dhe plan të punës, në mënyrë që të sigurohet një ambient sa më i mirë i punës, sa kohë që profesionalizmi rritet përherë e më shumë.

“

Në ekonominë e tregut, fokusimi vetëm në ofrimin e burimeve financiare, përderisa kapacitetet profesionale mbeten të pazhvilluara, është një gabim i madh.”

Ardiana Bunjaku, Drejtoreshë Ekzekutive



SCAAK encouraged all employers to look towards the future, and to draw inspiration by the extraordinary changes in the field of professional education and training.

SCAAK and its development partners agreed upon a clear vision of the future and its goals. The professional staff engaged within this process created a strategy and work plan, in order to ensure a better work environment as well as enhance professionalism.

Me zgjerimin e trajnimeve dhe shërbimeve të ofruara nga ShKÇAK, u rrit edhe personeli i Zyrës Ekzekutive, si në numër ashtu edhe në eksperiencë. Personeli i ShKÇAK-së përmirësoi mënyrën e ofrimit të shërbimeve, organizimin dhe ofrimin e mbështetjes profesionale që kërkohej për t'u ngritur ShKÇAK.

Mbështetja e vazhdueshme e komunitetit të donatorëve ka qenë një nga pikat kryesore që kanë ndihmuar ShKÇAK-në si një organizatë jofitimprurëse (organizatë me përfitim publik sipas rregulloreve kosovare), që t'u shërbejë nevojave të ekonomisë për kuadro të trajnuara në kontabilitet dhe financa. Në vitin 2003 ShKÇAK u bë një Anëtar i Asociuar i IFAC, gjë që ofroi një kontekst për të ardhmen.



Focusing only on the provision of financial resources, whilst not developing a professional capacity for a market economy at the same time, would be a mistake."

Ardiana Bunjaku, Executive Director



As the demand for SCAAK training and services grew, the Executive Office staff grew in both numbers and experience. Working closely with consultants, the staff of SCAAK learned the fundamentals of service delivery, organization and professional support required to build SCAAK.

The continued support of the donor community was essential in helping SCAAK, as a not for profit organization (public benefit body under Kosovo regulations), to serve the needs of the economy for trained accounting and finance staff. By 2003 SCAAK became an Associate Member of IFAC, which provided a context for its further development.



“ SHKÇAK rritet me shumë ndihmë, këshilla dhe këmbëngulje nga shumë burime (jo të pakta ishin përpjekjet e stafit të vet si dhe anëtarëve të hershëm) dhe tani është rritur, është një “gjë” e re dhe e mençur. Kjo është diçka që më bën të jem shumë krenare që jam e lidhur me të. Nuk është shumë e shpeshtë që një këshilltar të shoh një sukses për një periudhë kaq të shkurtër.

SCAAK grows with lots of help, advice and perseverance from many sources (not least were the efforts of its own staff and early members) and now it's a grown up and clever young “thing”. It's something that I am so proud to be associated with. It's not often in one's consulting life that one can see success in such a short time.”

Thuy Mellor

Ish këshilltare dhe bashkëpunëtore e ShKÇAK / Consultant and co-operator of SCAAK



“ Në këtë kohë të sfidave të përditshme, ShKÇAK është shembulli më i mirë i përballjes me to për 10 vite me radhë për të arritur aty ku jemi sot. Vazhdojmë më tutje, ky nuk është fundi, është vetëm fillimi.

At this time of everyday challenges, SCAAK is the best example of overcoming them – in 10 years, reaching at the peaks we find ourselves today. We will for sure keep going, as this is not the last milestone, but just the beginning of the journey.”

Lendita Shahini Ustaibo

Udhëheqëse e administratës / Head of Administration Department



“ Unë e dua SHKÇAK dhe Royal NIVRA (Holandë) ka dëshirë të punojnë me SHKÇAK për shkak se ekipi i SHKÇAK është shumë pro aktiv në vetëdijesimin se profesioni i kontabilitetit ka një përgjegjësi të madhe ndaj interesit publik dhe ndaj shoqërisë. Me këtë strategji, SHKÇAK ka dëshmuar se është një shembull i shkëlqyer në Ballkan. Strategjia e zgjedhur e justifikon plotësisht anëtarësimin e plotë në IFAC.

I love SCAAK and Royal NIVRA (Netherlands) loves to work with SCAAK because the SCAAK team is very pro active in creating awareness that the accountancy profession has a huge responsibility towards public interest and society. With this strategy SCAAK has a proven example role in the Balkan area. The chosen strategy fully justifies full membership with IFAC.”

Paul F.M. Hurks RA

Menaxher i zhvillimeve ndërkombëtare, Royal NIVRA Holandë / Officer for SCAAK Member Service Department



“ Familja më e përsosur është ajo që komunikon, debaton dhe ku secili anëtarë ka të drejtën e shprehjes, kjo e ka bërë Zyrën Ekzekutive të jetë ajo që është sot. Është kënaqësi të jesh pjesë e kësaj zyre dhe e këtij kolektivi.

The perfect family is one that communicates, discusses and where each member has the right of expression and this is what has made the Executive Office be what it is today. It is a pleasure to be part of this office and this collective.”

Lulzim Zeka

Këshilltar i Departamentit Profesional / *Consultant of the Professional Department*



“ Nga përvoja ime në SCAAK kam mësuar se të jesh një organizatë e suksesshme duhet që të punosh me sinqeritet dhe të japësh maksimumin.

My experience in SCAAK made me learn that success, for any organization is a result of hard work and sincerity.”

Drin Kryeziu

Ish zyrtar i marketingut / *Ex Marketing Officer*



“ Të jesh pjesë e ShKÇAK është privilegj. Të punosh në interes të publikut është përgjegjësi. Të përjetosh sukseset e ShKÇAK është kënaqësi.

Being a part of SCAAK is a privilege. Working in the interest of the public is a responsibility. Experiencing the success of SCAAK is a big pleasure.”

Burim Ahmeti

Zyrtar ligjor/prokurim / *Legal Officer/Procurement*

“ Me dhjetëvjetorin e parë i cili ka shënuar arritje të mëdha, udhëtimi i ShKÇAK veç sa ka filluar. Ne gjeneratat më të reja të ShKÇAK duke marr shembull punën e stafit, që prej fillimit kanë përkushtuar, lirisht mund të them, jetën e tyre për zhvillimin e Shoqatës dhe profesionit, do të punojmë palodhshëm që në dekadat e ardhshme të kemi tregime po aq të suksesshme.

Although it is only its 10th Anniversary, the journey the SCAAK has been off to, seems to have scored great achievements. We, SCAAK's younger generations, have our role models in our future work with the Society, the older generations of staff who, (I can easily state) have dedicated their own lives to the development of the Society and profession – and we will never stop working so that we can have stories just as successful for the coming decades.”

Edona Perjuci Uka
Udhëheqëse e Departamentit Profesional /
Head of the Professional Department



“ Shoqata me suksesin e arritur, ka vendosur një pikë të re referimi për standardet më të larta të edukimit. With the success it has achieved, the Society has set a new point of reference for the highest standards of education.”

Arbër Hoti
Zyrtar i shërbimit për anëtarë dhe anëtar i Komisionit për edukim profesional /
Officer for SCAAK Member Service Department

Zhvillimi i kapaciteteve të studentëve dhe anëtarëve

Gjatë dhjetë viteve të parë të këtij profesioni në Kosovë, ShKÇAK ka ndryshuar tri herë formën e programit të saj të certifikimit.

Plan-programi origjinal, i adaptuar në vitin 2002 nga BKSFR, u shërbente nevojave emergjente të Kosovës për të pajisur shpejt e shpejt dhe në mënyrë intensive studentët dhe anëtarët për të përmbushur nevojat e punëdhënësve me aftësi të reja dhe të azhurnuara.

Pas pranimit të ShKÇAK-së në IFAC si Anëtar i Asociuar në vitin 2003, Zyra Ekzekutive filloi implementimin e Manualit Këshillues për Administrimin e Provimeve të IFAC-së, ndërsa merrte në konsideratë mënyrën se si mund të azhurnohej plan-programi për të implementuar më tej Plan-Programin Model të UNCTAD-it për kontabilistë profesionistë dhe Udhëzimet Ndërkombëtare të Edukimit të IFAC-së.



Organizimi i provimeve dhe anëtarët e ShKÇAK.

Exams and SCAA Members.

Developing capacity of students and members

During the first ten years of the profession in Kosovo, SCAA changed the shape of its certification program three times.

The original syllabus, adopted in 2002 by the KBSFR served the needs of Kosovo to quickly and intensively equip students and members to meet the demands of employers for new and updated skills.

Following admission of SCAA into IFAC as an Associate in 2003, the Executive Office commenced implementation of the IFAC Examinations Administration Advisory manual, as well as consider how the first syllabus could be upgraded to further implement the UNCTAD Model Curriculum for professional accountants and the IFAC International Education Guidance.

Në vitin 2005 ShKÇAK implementoi plan-programin e dytë, duke orientuar më tej programin e saj profesional me praktikat më të mira ndërkombëtare, dhe duke pasqyruar standardet dhe vlerat e IFAC-së.

Pavarësisht prej normës së ulët të kalueshmërisë në vitet e para, SHKÇAK krijoi shpejt besueshmëri të lartë për sistemin e saj të provimeve, duke përshtatur menjëherë Manualin Këshillues për Administrimin e Provimeve të IFAC-së dhe duke e implementuar atë në Kosovë.

Vendimi për azhurnimin e plan-programit në vitin 2005 për ta integruar atë me praktikat më të mira, në vetvete përfaqësonte një sfidë. Studentët e ardhshëm, bashkë me disa prej studentëve dhe anëtarëve të ShKÇAK-së, krahasonin kualifikimet me ato të ofruara në vende të tjera në Kosovë, me numrin relativisht të vogël të lëndëve të ofruara në universitete, dhe shprehnin haptazi dyshimet e tyre për qasjen e re të ShKÇAK-së. Kështu filloi një fushatë për të edukuar komunitetin në mënyrë që ata të mund të krahasonin kualifikimet e ShKÇAK-së me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit të IFAC-së, ndërsa filloi marrja e ofertave nga organizmat profesionistë të Bashkimit Evropian.



In 2005 SCAAK implemented the second syllabus, further aligning the professional program with international best practice, and reflecting the standards and values of IFAC.

Despite high examination failure rates in the early years, SCAAK quickly gained a reputation for the credibility of its examination system as the IFAC Exam Administration guidance was fully adapted and implemented in Kosovo.

The decision to upgrade the syllabus in 2005 to further integrate with best practices represented a challenge. Potential students, as well as some of the SCAAK students and members compared the qualifications with those offered elsewhere in Kosovo, principally the relatively small number of courses offered in Universities, and openly questioned the need for the approach of SCAAK. A campaign to educate the community such that they would compare SCAAK's qualifications with the IFAC international education standards, and the offerings from the EU professional bodies was initiated.

Në vitin 2006 Banka Botërore përpiloi Raportin e Parë mbi të Vepruarit në Përputhje me Standardet dhe Kodet në Kontabilitet dhe Auditim. Ky raport domethënës ofronte një vlerësim të pasur dhe të saktë të gjendjes së kornizës së raportimit financiar në Kosovë. Raporti ofronte një axhendë për reforma për Kosovën dhe u mirëprit nga ShKÇAK dhe Qeveria e Kosovës.

Gjatë vitit 2006, një kontabilist skocez, i cili punonte si këshilltar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë të Kosovës me një projekt të financuar nga Bashkimi Evropian, u bë mik i ShKÇAK-së. Mike Mann nuk arrinte të kuptonte funksionin dhe rolin e Zyrës së Regjistrimit të Bizneseve dhe kur zbuloi se roli i saj ishte të hartonte dhe të publikonte pasqyra të audituara financiare, ai u lidh me ShKÇAK-në për të parë nëse zyra në fjalë mund të bëhej funksionale. Mike zbuloi se pasqyrat financiare nuk përgatiteshin në mënyrë konsistente, nuk dorëzoheshin siç duhej ose në kohën e duhur, dhe se mungonte tërësisht një sistem i kontrollit për faktin nëse pasqyrat në fjalë ishin apo nuk ishin audituar.



Kongresi Botëror i Kontabilistëve, Stamboll 2006 dhe Mike Mann në takimin vjetor të ShKÇAK, 2006.

WCOA, Istanbul 2006 and Mike Mann at SCAAK Annual Meeting, 2006.

In 2006 the World Bank conducted the first Report on Observance of Standards and Codes in Accounting and Auditing. This major report provided a rich and accurate assessment of the state of the financial reporting framework in Kosovo. The report provided an agenda for reform for Kosovo, and was welcomed by SCAAK and the Government of Kosovo.

During 2006 a Scottish accountant who worked as an adviser to the Ministry for Trade and Industry in Kosovo on an EU funded project became a friend to SCAAK. Mike Mann could not understand the function and role of the Business Registry, and when he discovered that its role was to collect and publish audited financial statements, he linked up with SCAAK to see if the registry could be made operational. Mike discovered that financial statements were not prepared consistently, filed properly or on time, and the absence of a system of checking whether they had been audited or not.

Pasi Mike Mann i raportoi Komisionit Evropian (KE/EC) se ShKÇAK kishte nevojë për një projekt të madh transformues që të ndihmonte Kosovën dhe ShKÇAK-në për të përballuar sfidat e identifikuara nga Raporti i Parë mbi të Vepruarit në Përputhje me Standardet dhe Kodet në Kontabilitet dhe Auditim, KE/EC u dakordua dhe zhvilloi një propozim, i cili do të ndihmonte Ministrinë e Financave, BKSFR-në, ShKÇAK-në dhe palët e tjera me interes, që të bënin progres gjatë zhvillimit të kapaciteteve për kontabilitet dhe auditim në Kosovë.

Projekti për Raportimin Financiar të Korporatave filloi në mars 2007, nën udhëheqjen e Liam Coughlan-it.

Në korrik 2007, ShKÇAK lansoi një plan 5-vjeçar “ShKÇAK 2012”, i cili përmbante një strategji për të implementuar Deklaratën e Obligimeve të Anëtarësisë në IFAC (DOA/SMO).

Në Asamblenë e ShKÇAK-së në vitin 2007, anëtarët adaptuan një statut të ri, i cili qartësonte misionin e SHKÇAK-së për t’i shërbyer interesit të publikut, qëllimeve kryesore të Shoqatës dhe, çështje më e rëndësishme, që përfshinte DOA/SMO e IFAC në statut, duke e bërë të detyrueshëm implementimin e tyre.



Takimi vjetor, 2007.

Annual meeting, 2007.

When Mike Mann reported to the European Commission (EC) that SCAAK needed a major transformative project to help Kosovo and SCAAK to meet the challenges identified by the ROSC, the EC agreed and developed a proposal that would assist the Ministry of Finance, KBSFR, SCAAK and other stakeholders in making progress in developing accounting and audit capacity in Kosovo.

The Corporate Financial Reporting Project was launched in March 2007, led by Liam Coughlan.

In June 2007, SCAAK launched a major 5 year plan “SCAAK 2012” which contained a strategy to implement the IFAC Statements of Membership Obligations (SMO).

At the Assembly of SCAAK 2007, the members adopted a new statute that clarified SCAAK’s mission to serve the public interest, the principal aims of the Society and most important, embedded the IFAC SMOs into the statute, mandating their implementation.

Nga kjo pikë, ShKÇAK punonte pa u lodhur me këshilltarët e rinj të projekteve dhe implemtoi një gamë të gjerë reformash. Programi i edukimit profesional u rishikua tërësisht, duke u bazuar në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit në Kontabilitet dhe kërkesat e Direktivës së Tetë të EU të Ligjit të Kompanive për kërkesat për miratimin e auditorëve.

Plan-programi i ri i ShKÇAK-së u lansua në 10 dhjetor 2007.

Pas fazës së parë të programit të ri të edukimit profesional, ShKÇAK nënshkroi marrëveshjen e parë të këtij lloji me BPP-në në Mbretërinë e Bashkuar, që është ofruesi kryesor në Evropë i materialeve për edukimin profesional në kontabilitet dhe auditim, për t'i përkthyer materialet e trajnimeve në gjuhën shqipe. Çdo vit BPP përpilon azhurnime të materialeve të trajnimit, për të pasqyruar ndryshimet në standarde e udhëzime dhe kjo marrëveshje tregon se ShKÇAK ka qasje të pakufizuar ndaj materialeve të azhurnuara për trajnime.



From this point on SCAAK worked tirelessly with the new project consultants and implemented a wide ranging set of reforms. The professional education program was completely overhauled, and based upon the requirements of International Accounting Education Standards, and the requirements of the EU 8th Company Law Directive on the requirements for the approval of auditors.

The new SCAAK curriculum was launched on December 10th 2007.

Following the design phase of the new professional education program, SCAAK signed the first agreement of its type with BPP UK, who is Europe's leading provider of professional accounting and auditing education materials, to translate the training materials in local languages. BPP produces updates of training materials every year, to reflect changes in standards and guidance, and this agreement meant that SCAAK had access to a source of annually updated training materials.

Paralelisht me zhvillimin e programit për edukim profesional për personat që sapo kishin nisur këtë profesion, ShKÇAK dhe projekti i financuar nga KE/EC për anëtarët zhvilluan më tej Skemën e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional. Që nga viti 2007 e deri sot, ShKÇAK ka zbatuar konceptin e angazhimit të këshilltarëve më të mirë vendorë dhe ndërkombëtarë për të ofruar EVP dhe ka integruar përpjekjet e tij me programe të financuara nga donatorë të tjerë.

Bashkëpunimi i shkëlqyeshëm i ndihmuar nga ShKÇAK midis programeve të KE/EC e US-AID-it dhe personeli i departamentit profesional të ShKÇAK-së kanë siguruar mbështetjen për krijimin e një Departamenti të Kontabilitetit në Universitetin e Prishtinës. Pesë studentë kosovarë kanë kryen Studimet Pasuniversitare në Universitetin e Arizonës në vitin 2009, me financimin e USAID-it, për t'u krijuar kështu një bërthamë aq shumë e nevojshme e një gjenerate të vogël por të re të profesorëve të ardhshëm të kontabilitetit.



In parallel with the development of the professional education program for new entrants to the profession, SCAAK and the EU funded project further developed the Continuing Professional Education scheme for its members. During the period 2007 to date, SCAAK innovated the concept of utilizing the most experienced available local and international consultants to provide CPD, and integrated its efforts with other donor funded programs.

Excellent collaboration facilitated by SCAAK between the EC and USAID programs and SCAAK professional department staff generated support for the establishment of a department of accounting at the University of Pristina. 5 Kosovar students completed their Masters Degrees at Arizona University in 2009, funded by USAID, thus providing a much needed injection of a small but dynamic new generation of future professors of accounting.

Në vitin 2008 BKSFRF zgjodhi Z. Fatmir Gashin si Kryetar të tij dhe nga që nga ajo kohë bordi në fjalë punoi shumë me këshilltarët e projektit dhe ShKÇAK-në, për të zhvilluar udhëzime administrative, në mënyrë që të implementohen kërkesat e Direktivës së BE-së për Auditime Ligjore, për sa kohë që diçka e tillë lejohet nga Rregullorja 2001/30 e UNMIK-ut.

Megjithëse programi fillestar i asistencës që i ishte ofruar ShKÇAK-së i vitit 2007, vinte nga BE, ShKÇAK, bashkë me ekipin e projektit të BE-së, vazhduan të bashkëpunonin në mënyrë të shkëlqyeshme edhe me programe të tjera të donatorëve. Programi i financuar nga USAID për Krahësimin me Standardet Ndërkombëtare të Transparencës dhe Kontabilitetit i ofroi ShKÇAK-së bashkëpunimin me Z. Paul Hurks, këshilltar për Royal NIVRA, Instituti Holandez i Kontabilistëve të Autorizuar. Kjo marrëdhënie bëri që të krijohet një sponsorizim zyrtar nga Royal NIVRA për ShKÇAK-në, për anëtarësimin e plotë në IFAC në vitin 2009.



Edukimi dhe trajnimet profesionale janë të nevojshme për të mundësuar krijimin e kushteve për zhvillimin afat – gjatë të ekonomisë dhe shoqërisë në përgjithësi. Reputacioni i Shoqatës për sa i takon shkëlqyeshmërisë, integritetit dhe ekspertizës po rritet përherë e më tepër, si në Kosovë edhe në shkallë ndërkombëtare dhe kjo mundëson përparimin e karrierës për anëtarët tanë.”

Naim Avdiu

Kryetar i Këshillit të ShKÇAK (2007-2010)



In 2008 the KBSFRF elected Mr Fatmir Gashi as its President, and from that time worked extremely well with the project consultants and SCAAK to develop administrative instructions to implement the requirements of the EU Statutory Audit Directive, insofar as the existing UNMIK Regulation 2001/30 permitted.

Though the primary assistance program available to SCAAK from 2007 was provided by the EU, SCAAK as well as the EU project team continued to work with excellent co-operation with the other donor programs. The USAID funded Benchmarking International Standards of Transparency and Accountability program inducted SCAAK to Mr Paul Hurks, consultant to Royal NIVRA, the Dutch Institute of Chartered Accountants. This relationship would lead to the formal sponsorship by Royal NIVRA of SCAAK for full IFAC membership in 2009.

Programi i ri i edukimit profesional, përfshirë aktivitetet e EVP-së, e ndihmoi ShKÇAK që të rrisë në mënyrë të ndjeshme njohjen e saj brendapërbrenda Kosovës. Në qershor 2008, ShKÇAK mirëpriti një delegacion të Anëtarëve të Parlamentit Evropian. Gjatë asaj jave, edhe ShKÇAK edhe BKSFR, mirëpritën Shefin e Këshillit të Mbretërisë së Bashkuar për Raportimin Financiar dhe Kryetarin aktual të Këshillit Ndërkombëtar për Raportimin Financiar - Z. Ian Macintosh, bashkë me Z. Jon Hooper, sekretar ekzekutiv i Forumit Ndërkombëtar për Rregullimin e Pavarur të Auditimit (IFIAR), i cili u mbajti leksione të EVP-së anëtarëve të ShKÇAK-së. Gjatë këtyre viteve, ShKÇAK pati fatin të organizonte një gamë të gjerë leksionesh të EVP-së nga ekspertë të huaj me eksperiencë, përfshirë Paul Hurks, Bill Phelps, Dr. Gert Karreman.

Në vitin 2009 Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë (ECLO) ofroi një projekt të ri për të zhvilluar kapacitetet e Ekspertëve të ardhshëm për Falimentime në Kosovë.

“ Education and professional training are needed in terms of enabling conditions for long-term development of economy and society in general. Association's reputation for excellence, integrity and expertise is growing, both in Kosovo and internationally and that enables career advancement for our members.”

Naim Avdiu

President of SCAAK Council (2007-2010)



The new professional education program, including the CPD activities helped SCAAK to greatly increase its visibility within Kosovo. In June 2008 SCAAK hosted a delegation of Members of the European Parliament. During the same week, both SCAAK and the KBSFR hosted the Chairman of the UK's Financial Reporting Council, and current President of the International Financial Reporting Council Mr Ian Macintosh together with Mr Jon Hooper, executive secretary of the International Forum for Independent Audit Regulation (IFIAR) in Pristina, who provided CPD lectures to SCAAK members. During these years SCAAK were fortunate to have attracted a large range of CPD lectures from highly experienced foreign experts including Paul Hurks, Bill Phelps, Dr Gert Karreman.

In 2009 the European Commission Liaison Office in Kosovo (ECLO) provided a new project to develop the capacity of future Insolvency Practitioners in Kosovo.

Duke përdorur të njëjtën qasje të suksesshme që përdoret për të zhvilluar kualifikime në fusha të specializuara të studimit për kontabilistët e çertifikuar, ShKÇAK punoi në projektin për të zhvilluar një qasje të tillë edhe për fushat ligjore, që ishte e krahasueshme me praktikën dhe standardet evropiane. ShKÇAK arriti qëllimin duke pasur tre kosovarët e parë të trajnuar dhe të pranuar si anëtarë të INSOL EUROPE - Ardiana Bunjaku, Edona Perjuci-Uka dhe Burim Ahmeti, sa kohë që vetë ShKÇAK ka zhvilluar një trajnim të qëndrueshëm, i cili përmbush nevojat e atyre që dëshirojnë të specializohen në këtë fushë.

Ky program ka identifikuar nevojat e ardhshme të Kosovës për zhvillimin e kontabilistëve me ekspertizë specifike për trajtimin e kompanive që janë në vështirësi financiare, dhe u përgjigjet nevojave për ndërtimin e kapaciteteve për Agjencinë e Privatizimit të Kosovës, duke pajisur edhe personelin ligjor edhe atë të kontabilitetit, me njohuri më të mëdha për të trajtuar kompanitë në vështirësi financiare.



Utilizing the same successful approach to develop the qualification as a specialist area of study for certified accountants, and also qualified lawyers, SCAAK worked with the project to develop an approach to qualification that was benchmarked to European practice and standards. SCAAK achieved its aims of having three first Kosovars trained and admitted to membership of INSOL EUROPE, Ardiana Bunjaku, Edona Perjuci-Uka and Burim Ahmeti, and SCAAK had a sustainable course that met the needs of those wishing to specialize in this area.

This program addressed the future needs of Kosovo to develop accountants with specific expertise in dealing with companies in financial distress, and also respond to capacity building needs of the Privatization Agency of Kosovo in equipping both legal and accounting staff with a greater awareness of the skills and expertise needed to deal with companies in financial distress.

Gjatë kësaj faze të zhvillimit të shpejtë, ShKÇAK kërkonte të rriste kapacitetet dhe të mund t'u jepte përgjigje nevojave të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Në vitin 2008 Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Kosovës, zgjodhi ShKÇAK-në si ofruesin e një serie trajnimesh për personelin e saj të angazhuar në menaxhimin financiar të sektorit publik. Reputacioni i ShKÇAK-së për profesionalizmin, integritetin dhe seriozitetin, që e shquajnë, bëri që institucionet qeveritare të fitojnë besim të plotë për ta angazhuar shoqatën edhe për çertifikimin e kontabilistëve në sektorin publik.

ShKÇAK ka siguruar ekskluzivitetin për çertifikimin e kontabilistëve në sektorin publik, një titull profesionist që u mundësua nëpërmjet implementimit të përbashkët me Qendrën për Përsosmëri në Financa (CEF) të Sllovenisë për programin e çertifikimit për kontabilitet në sektorin publik, zhvilluar nga Instituti i Autorizuar i Mbretërisë së Bashkuar për Financa dhe Kontabilitet Publik (CIPFA).



During this phase of rapid development, SCAAk sought to leverage its capacities and remain responsive to the needs of different sectors of the economy. In 2008 the Ministry of Finance of Kosovo designated SCAAk as the provider of a series of courses for its staff engaged in public sector financial management. SCAAk's reputation for professionalism, integrity and seriousness caused the governmental institution to gain full trust by turning to the Society for certifying accountants in the public sector.

SCAAk has gained exclusivity for certifying accountants of the public sector, a professional title made possible through the shared implementation with the Center of Excellence in Finance (CEF) Slovenia of the public sector accounting certification program, developed by the UK Chartered Institute for Public Finance and Accountancy (CIPFA).

Për më tepër, përmirësimi i efikasitetit në Menaxhimin Financiar Publik ka qenë një nga objektivat e Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave, Z. Ahmet Shala.

SHKÇAK bashkëpunoi me Bearing Point (USAID), me Departamentet e Thesarit, të Buxhetit dhe me të gjitha institucionet përkatëse qeveritare, në mënyrë që të organizonte kurse trajnimi dhe të përpilonte materialet e duhura.

Në fund të kësaj periudhe 10-vjeçare, ShKÇAK ka zhvilluar kapacitetet e duhura për t'u shërbyer nevojave të ekonomisë me teknika të kontabilitetit, kontabilistë të çertifikuar dhe auditorë të çertifikuar, të cilët janë trajnuar me standarde të barasvlefshme me ato të Evropës Perëndimore. Gjatë gjithë kësaj kohe, ShKÇAK u përgjigjej nevojave të identifikuara nga Qeveria dhe punonjësit e sektorit privat. Një nga pikat kyçe të kësaj periudhe, ishte mënyra se si u arrit bashkërendimi midis donatorëve, bashkë me angazhimin dhe mbështetjen nga ekspertët, për të zhvilluar kornizën financiare të Kosovës.



Bashkëpunimi me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.

Cooperation with the Ministry of Economy and Finance.

Moreover, the improvement of efficiency in Public Financial Management was an objective of the Minister of Economy and Finance, Mr. Ahmet Shala.

SCAAK collaborated with Bearing Point (USAID), with the Treasury, the Budget and with other relevant governmental institutions in order to arrange training courses and needed materials.

By the end of the 10 year period, SCAAK had developed the capacity to serve the needs of the economy with accounting technicians, certified accountants and certified auditors that were trained to standards equivalent to those in Western Europe. Along the way SCAAK responded to needs identified by Government and private sector employers. One of the highlights of this period was the way in which donor coordination was achieved, as well as the great commitment and support from the experts provided to develop Kosovo's financial framework.

Historia e ShKÇAK-së duhet t'u shprehë mirënjohjen të gjithë partnerëve të saj në zhvillim, Komisionit Evropian (ECLO), Bankës Botërore dhe USAID-it.

Donatorët, bashkëpunëtorët dhe anëtarët e ShKÇAK.



SCAAK donors, partners and members.

SCAAK's history should record the appreciation to all of its partners in development, the European Commission (ECLO), the World Bank and USAID.



“ Edhe pse kam kaluar 25 vite duke punuar në zhvillimin e shoqatave profesionale në shumicën e kontinenteve, ShKÇAK përfaqësonte përvojën më shpërblyese për shkak të përkushtimit 100% dhe të dëshirës së Këshillit dhe stafit të ShKÇAK që të arrijë sukses. Shumë pak përfitues të projekteve motivojnë konsulentët të punojnë 24 orë në ditë e 7 ditë në javë, por është e vështirë për ndonjë profesionist të zhvillimit të shkojë në shtëpi në ora 18:00 në mbrëmje kur njerëzit e tillë të dedikuar vazhdojnë të punojnë deri në orët e vona.

In my more than 25 years of work of developing professional organizations, in many continents, SCAAK represents the most rewarding experience, mostly due to the full perseverance and dedication to success of its Council and staff members. Very few beneficiaries, really motivate their consultants to work 24 /7, but it is so impossible to go back home by 18:00, while such dedicated persons continue to work until late at night.”

Liam Coughlan

Ish udhëheqës i ekipit, Projektet e BE / Ex team leader, EU Projects



“ Mos i shiko vështirësitë si pengesa që duhen shmangur por si sfida që duhen kaluar. Me punë dhe me përkushtim Shoqata i kaloi këto sfida.

Don't look at difficulties as obstacles to avoid, but as challenges to overcome. With work and deduction SCAAK passed these challenges.”

Besarta Ajeti

Asistente Financiare / Finance Assistant





“

Jam shumë e kënaqur dhe njëkohësisht krenare që kam qenë pjesë e këtij projekti madhor. USAID ka ndihmuar ShKÇAK në ditët e hershme duke iu siguruar materialet për trajnim si dhe duke iu ndihmuar rreth ligjëruesve. Mund të them se ka qenë një eksperiencë e mrekullueshme të punosh me një staf të përkushtuar dhe profesional. Unë mbaj mend të gjithë stafin kur të përkushtuar dhe me entuziazëm punonin drejt një qëllimi dhe sot shoh që ende mbetet njëjtë.

I am delighted and proud at the same time to have been part of this major and successful project. USAID has helped SCAAK in the early days with trainers and training materials and I can say that it has been a tremendous experience working with such a professional and committed staff. I remember the enthusiasm and dedication of the whole team working hard toward that same goal, which I see remains to this day.”

Dardane Peja

Specialiste e programit për zhvillim, USAID/Kosovë / Development Program Specialist, USAID/Kosovo





Gjërat e domosdoshme të një shoqërie nuk mund t'i quajmë ndryshime, ShKÇAK ndryshoi deri në përsosmëri të domosdoshmet.

The things that a society deems necessary, cannot be called modifications, - but SCAAK modified such necessities to excellence.

Lulzim Berisha

Këshilltar në Departamentin Profesional /
Consultant of the Professional Department



Në Shoqatën tonë disiplina, mendjet e ndritura dhe zemrat e mëdha janë urë lidhëse mes qëllimeve dhe rezultateve të përbashkëta.

The bridges connecting our Society's aims with its achievements are simply work discipline, bright minds and open hearts.

Ermal Kozgori

Asistent në Departamentin Profesional / Assistant of the Professional Department



Mësimi është proces që nuk përfundon me shkollën, por vazhdon gjithë jetën. Në ShKÇAK ndihem e pëmbushur dhe pjesë aktive e këtij procesi.

Learning, as a process end by the conclusion of the school-years, it continues throughout the whole life. In SCAAK, I feel accomplished by being an active part of this process."

Burbuqe Gjonbalaj

Zyrtare e Shërbimit për studentë / Officer for Student Services



Arritjet e Shoqatës janë sukseset e arritura me punë të palodhshme, dedikim në punë dhe planifikim. Puna profesionale i tejkaloi sfidat dhe arriti që Shoqata të depërtoj në kulminacionin e suksesit.

The achievements of our Society are a pure result of full dedication, good planning and hard work. Only via its professional work the Society surpassed the challenges and managed to reach the peaks of its success."

Fiona Beqiri

Asistente e shërbimit të Studentëve / Student Service Assistant



Promovimi dhe vënia në zbatim e standardeve ndërkombëtare

ShKÇAK ka pasur një dekadë bashkëpunimi me KBSFR dhe ka përdorur influencën e saj për të mbështetur Bordin gjatë vënies në zbatim të standardeve ndërkombëtare.

Në vitin 2006 Raporti i Bankës Botërore mbi të Vepruarit në Përputhje me Standardet dhe Kodet në Kontabilitet dhe Auditim identifikoi shumë mangësi në sistemin e raportimit financiar të Kosovës, përfshirë kornizën për standarde, dhe KBSFR, së bashku ShKÇAK-në, kanë punuar për të adresuar disa nga rekomandimet kryesore të politikave, brendapërbrenda kornizës së ligjit 2001, i cili tashmë kishte humbur funksionin.

Me asistencën e Znj. Thuy Mellor, këshilltare nga Projekti i KE/EC për raportimin financiar të korporatave, u përpilua Projektligji mbi Raportimin financiar, bashkë me Ministrinë e Financave, KBSFR-në dhe ShKÇAK-në.

Versioni draft i standardit të IFRS-së për NVM/SME, u përkthye shqip brenda disa javësh pas hyrjes së tij në fuqi dhe KBSFR dhe ShKÇAK organizuan disa sesione të EVP-së, për ta sqaruar atë.



Promoting and implementing international standards

SCAAK has had a decade of cooperation with the KBSFR, and has used its influence to support the Board in implementation of international standards.

The 2006 World Bank Accounting and Auditing ROSC report identified many shortcomings in the financial reporting system of Kosovo, including standards framework, and both KBSFR and SCAAK worked jointly to address some of the major policy recommendations, within the limits of the 2001 Law, which by then was becoming outdated.

